

20222363433

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

**L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SË FËMIJËVE**

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21 dhe 150/22), neni 166-b ndryshon si vijon:

“(1) Komponentin themelor të pagës e përbëjnë:

- Paga minimale
- Pjesë e pagës për shkallën e arsimit
- Pjesa e pagës për nivelin, dhe
- Pjesa e pagës për stazhin e punës.

(2) Paga minimale është ajo që ministri i Punës dhe i Politikës Sociale e publikon në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë në përputhje me ligjin.

(3) Pjesa e pagës për shkallën e arsimit, që është minimumi ligjor për nivelin përkatës të punës, vlerësohet në këtë mënyrë:

NIVELI IKUALIFIKIMEVE/ARSIMIMI	PIKË
Niveli i kualifikimeve VIA, 240 kredi sipas SETK-së ose të përfunduar shkallën VII/1	56
Niveli i kualifikimeve VIB ose 180 kredi sipas SETK-së	31
Niveli i kualifikimeve VA, 60 për 120 sipas SETK-së ose arsim të lartë	11
Niveli i kualifikimeve IV, 240 sipas ECVET ose MKSOO ose arsimin e mesëm katërvjeçar	1

(4) Pjesa e pagës për nivelin ku është sistemuar ofruesi i shërbimit publik vlerësohet në këtë mënyrë:

NIVELI	PIKË
A1 udhëheqës i objektit	207
B1 punëtor profesional-këshilltar	184
B2 punëtor profesional-mentor	167
B3 punëtor profesional	155
B4 punëtor profesional-praktikant	94
V1 edukator-këshilltar	178
V2 edukator - mentor	155
V3 edukator	143
V4 edukator-praktikant	85
G1 bashkëpunëtor profesional-këshilltar	109
G2 bashkëpunëtor profesional-mentor	103
G3 bashkëpunëtor profesional	98
G4 bashkëpunëtor profesional- praktikant	48
D1 përkëdhelës/punëtor profesional ndihmëskëshilltar	92

D2 përkëdhelës/punëtor profesional ndihmësmentor	89
D3 përkëdhelës/punëtor profesional ndihmës	66
D4 përkëdhelës/punëtor profesional-ndihmëspraktikant	11

(5) Pjesa e rrogës për stazhin e punës të dhënësit të shërbimit publik vlerësohet në shumë prej 0.5 % nga pjesët e rrogës për nivelin e arsimit dhe për nivel, për çdo vit të përfunduar stazh pune, a më së shumti deri më 20%”.

Neni 2

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji, me të cilat ndryshon neni 166-b do të zbatohen me pagesën e pagës së muajit shtator të vitit 2022.

Neni 3

Autorizohet Komisioni ligjvënës-juridik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.